

Statistikat e Pyjeve, 2023

Tiranë më 10 Shtator 2024: Në vitin 2023 fondi pyjor dhe kulloror i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.420.973 (ha), duke përfaqësuar 49,4 % të sipërfaqes gjithsej të vendit.

Tab.1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kulloror të Shqipërisë


Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe jo-produktive			
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2021	1.146.724	66,8	448.750	26,1	121.350	7,1	1.716.824	100
2022	1.146.725	66,2	449.175	25,9	136.002	7,9	1.731.901	100
2023*	969.855	68,3	366.105	25,8	85.013	5,9	1.420.973	100

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /Agjencia Kombëtare e Pyjeve

*Në të dhënat e vitit 2023 nuk përfshihet sipërfaqja e fondit pyjor dhe kulloror që ndodhet brënda zonave të mbrojtura (si rrjedhojë keto të dhëna janë objekt rishikimi)**

Në 2023 pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.420.973 (ha) që përfaqëson 68,3 % të fondit pyjor dhe kulloror. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 366.105 (ha) ose 25,8 % të fondit pyjor dhe kulloror. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe joproductive që janë pjesë e fondit pyjor, zënë një sipërfaqe 85.013 (ha) ose 5,9 % të këtij fondi.

Fig. 1 Sipërfaqja e Fondit Pyjor dhe Kulloror (000/ha)




*Në të dhënat e vitit 2023 nuk përfshihet sipërfaqja e fondit pyjor dhe kulloror që ndodhet brënda zonave të mbrojtura (si rrjedhojë keto të dhëna janë objekt rishikimi)**

Për publikim 10/09/2024


Në vitin 2023, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve, arrin në rreth 53.176.000 (m³), nga të cilat 93,9% e këtij vëllimi përbëhet nga pyjet publike dhe 6,1% nga pyjet private. Në vitin 2023 ka pasur një rënie prej 1,64 %, krahasuar me vitin 2022.

Fig. 2 Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve (000/m³)



Në vitin 2023, në fondin pyjor sipërfaqen më të madhe e zënë fletorët me 48,5 %, ndjekur nga shkurret me 38,0 % dhe halorët 13,5 %.

Fig.3 Fondi pyjor sipas strukturës së llojeve 2023 (%)



*Në të dhënat e vitit 2023 nuk përfshihet sipërfaqja e fondit pyjor që ndodhet brenda zonave të mbrojtura (si rrjedhojë keto të dhëna janë objekt rishikimi)**

Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë.


Tab. 2 Numri dhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura

Kategoria e zonës së mbrojtur	Numri i zonave (Nr)			Sipërfaqja (Ha)		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Rezervë Strikte Natyrore	2	0	0	4.800	0	0
Park Kombëtar	14	11	13	230.707	301.197	315.304
Monument Natyror	725	723	724	3.470	1.550	1.585
Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	25	24	30	169.275	224.014	222.049
Peizazh i Mbrojtur	6	10	9	97.333	81.923	87.107
Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	4	0	0	18.245	0	0
Gjithsej Total	776	768	776	523.831	608.684	626.045

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Zonat e mbrojtura në vitin 2023 zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 626.045 (ha) e cila përbën 44,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor si dhe rreth 21,8 % të sipërfaqes së përgjithme të vendit.

Fig. 4 Struktura e sipërfaqes së zonave të mbrojtura sipas kategorive (%)



Në vitin 2023 sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë parqet kombëtare me 50,3 % të sipërfaqes gjithsej, ndjekur nga rezervatet natyrore të menaxhuara me 35,5 %, peizazhet e mbrojtura me 13,9 % dhe monumente natyrore 0,3 %.

Metodologjia

Të dhënat mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështeten në të dhënat administrative me baze vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve

Sipas Vkm Nr. 433, Datë 8.6.2016 për Transferimin Në Pronësi Të Bashkive Të Pyjeve Dhe Të Kullotave Publike Informacioni mblidhet në të gjitha Bashkitë e vendit të cilat kanë detyrimin ligjor të raportojnë cdo tre muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjët, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Zonat e Mbrojtura: mund të kenë forma të ndryshme si, park kombëtar, zona të paprekura, zona të ruajtura nga komuniteti, rezervate natyrore dhe rezervate private natyrore. Sipas IUCN, “Një zonë e mbrojtur është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore.”